



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI**



URDHËR

NR. 6792/2, DATË 01/11/2012
PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS “PËR KONTRAKTIMIN E NJË KONSULENTI
NDËRKOMBËTAR PËR RASTIN E CEZ SHPËRNDARJE, QË DO TË ASISTOJË
ENTIN RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë“, i ndryshuar, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, si dhe të neneve 17 dhe 18 të Rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 392, datë 08.04.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”,

K O N S T A T O J S E :

Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, me shkresën nr. 1705/9 Prot, datë 31.10.2012, ka sqaruar nevojën e kontraktimit të një konsulenti ndërkombëtar për të asistuar Entin Rregullator të Energjisë për rastin e CEZ Shpërndarje. Në këtë shkresë, argumentohet se kjo çështje është shumë e vështirë për t’u ndjekur nga Avokatura e Shtetit, për shkak të kompleksitetit shumë të madh të çështjes, si dhe nevojës për njohuri mbi praktikën ndërkombëtare në fushën e licencimit në sektorin e energjisë. Në këtë kushte, është vlerësuar e drejtë kërkesa e Entit Rregullator të Energjisë, e paraqitur me shkresën nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012, për kontraktimin e një konsulenti ndërkombëtar, i cili do të kishte mundësi reale të ofronte konsulentë të kënaqshme në fushën licencimit në sektorin e energjisë.

PËR KËTË ARSYE:

Duke mbajtur në konsideratë vlerësimet e bëra në shkresën nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012 të Entit Rregullator të Energjisë, si dhe shkresën nr. 1705/9 Prot, datë 31.10.2012 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ku specifikohet kompleksiteti dhe rëndësia e kësaj çështje, si dhe faktin që:

1- kjo çështje është me rëndësi të veçantë për interesat e shtetit, sepse ka të bëjë me mbrojtjen dhe përfaqësimin sa më të mirë të interesave pasurore të shtetit, si dhe moscenimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë;



2- kjo çështje ka një natyrë të veçantë dhe të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuar;

3- për këtë çështje Enti Rregullator i Energjisë, ka çmuar të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen e një konsulenti ndërkombëtar, i cili do t'i asistojë dhe ndihmojë lidhur me rastin e CEZ Shpërndarje;

Në përputhje me ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, si dhe nenet 17 dhe 18 të Rregullores bashkëlidhur vendimit nr. 392, datë 08.04.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kërkesës së paraqitur nga Enti Rregullator i Energjisë, nëpërmjet shkresës nr. 683/3 Prot., datë 31.10.2012, për kontraktimin e një konsulenti ndërkombëtar, për të ofruar asistencë për rastin e CEZ Shpërndarje.

2. Një kopje e këtij urdhri i njoftohet menjëherë Entit Rregullator të Energjisë dhe Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

3. Fillimi i procedurave të vijojë menjëherë pas paraqitjes nga Enti Rregullator i Energjisë të përfaqësuesit të tij në Komisionin Përzgjedhës.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri, si dhe marrjen e masave për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me parimin e ligjshmërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
EDUARD HALIMI

